

**Deloitte.**

**ARMO Sh.A.**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat financiare më dhe  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

## **Përmbajtja**

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1-3
Pasqyrat Financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013	4
Pasqyra e fitimit ose humbjeve dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	7
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	8 - 44

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### *Aksionerëve dhe Drejtimit të ARMO Sh.A.:*

1. Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ARMO Sh.A., ("Shoqëria" ose ARMO) bashkangjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

2. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

### *Përgjegjësia e Auditorit*

3. Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.
4. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit, për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshi këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektetivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
5. Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të kualifikuar të auditimit mbi pozicionin financiar. Për shkak të çështjeve të trajtuara në paragrafin e refuzimit të performancës dhe rrjedhës së parasë, ne nuk ishim në gjendje të merrnim të dhëna auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të siguruar një bazë për një opinion auditimi mbi performancën financiare dhe rrjedhën e parasë.

*Bazat për refizimin e opinionit mbi performancën financiare dhe rrjedhën e parasë dhe të kualifikimit të pozicionit financiar*

6. Ne u caktuam si auditorë të Shoqërisë më 31 gusht 2013 dhe për këtë arsye nuk vrojtuan numërimin fizik të inventarit në fillim të vitit. Ne nuk ishim në gjendje të siguroheshim me anë të metodave alternative në lidhje me sasinë e inventarit të mbajtur gjendje më datë 31 dhjetor 2012. Meqenëse gjendja hapëse e inventarit përcakton performancën financiare dhe rrjedhën e parasë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të ishte e nevojshme të kryheshin rregullime në humbjen e vitit të raportuar në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera përmbledhëse si dhe rrjedhën neto të parasë nga aktivitetet operative të raportuara në pasqyrën e rrjedhës së parasë.
7. Shoqëria rregulloi gjendjen hapëse të “Aktiveve afatgjata materiale” në shumën 18,331 mijë Lek, “Huave ndaj shoqërive të tjera, neto” në shumën 619,362 mijë Lek, “Llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, neto” në shumën 227,158 mijë Lek, “Inventarë” në shumën 127,348 mijë Lek, “Aktiveve të tjera” në shumën 17,857 mijë Lek, “Huave dhe detyrime me interes” në shumën 263,246 mijë Lek, “Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera” në shumën 1,940,352 mijë Lek dhe “Detyrimeve të tjera” në shumën 1,179,778 mijë Lek, që rezultoi të kishte një efekt neto në pasqyrën e ndryshimeve në kapital në shumën 3,159,698 mijë Lek. Ne nuk ishim në gjendje të merrnim siguri të mjaftueshme dhe të përshtatshme në lidhje me rregullimet e gjendjeve hapëse. Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse këto rregullime janë të sakta dhe se çfarë efekti do të kishin ato në humbjen e vitit të raportuar në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe në rrjedhën neto të parasë nga aktivitetet operative të raportuara në pasqyrën e rrjedhës së parasë. Për më tepër, këto transaksione nuk janë regjistruar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, sipas të cilave Shoqëria duhet të rideklarojë pasqyrat financiare të vitit të kaluar.
8. Shoqëria nuk ka kryer rregullisht rivlerësime të aktiveve afatgjata materiale për t’u siguruar që vlera kontabël neto e tyre nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të caktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë më 31 dhjetor 2012 dhe jetëgjatësia e aktiveve nuk është vlerësuar periodikisht. Si rrjedhim, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse deficieti i rivlerësimit i njohur në pasqyrat financiare lidhet me periudhën aktuale dhe nëse shpenzimi i amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 është llogaritur saktë.
9. Siç është diskutuar dhe në Shënimin 34, në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Zvicër është në proces një çështje gjyqësore që përfshin Anika Enterprises S.A., ARMO Sh.A, Societe Generale de Surveillance S.A (SGS), dhe Wallis Trading Inc. për shumën 26,146,075 USD për sasinë e humbur të inventarit që është vendosur si kolateral në një financim të dhënë nga Wallis Trading Inc. Përveç kësaj, Wallis Trading Inc ka pretendime shtesë ndaj Shoqërisë në lidhje me një marrëveshje financimi të nënshkruar ndërmjet Wallis Trading Inc dhe ARMO Sh.A, Taci Oil ITSC, Anika Enterprises S.A. dhe KUID Sh.A në shumën 15,018,925 USD si dhe balanca të tjera shtesë të lidhura me to. Shoqëria është në proces shqyrtimi të vlefshmërisë së këtyre kërkesave. Rezultati përfundimtar i çështjeve të trajtuara më lart nuk mund të përcaktohet aktualisht nga Shoqëria, e cila nuk ka njohur asnjë provigjion në lidhje me detyrimet e mundshme. Duke patur parasysh informacionet më lart dhe në mungesë të procedurave alternative, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim detyrimet financiare totale të ARMO Sh.A. dhe ndikimin e tyre në performancën financiare dhe pozicionin financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013.

*Refuzimi i Opinioneve mbi Performancën Financiare dhe Rrjedhën e Parasë*

10. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të diskutuara në paragrafët 6 deri në 9 të "Baza për refuzimin e opinionit mbi performancën financiare dhe rrjedhës së parasë", ne nuk ishim në gjendje të merrim siguri të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar një bazë për dhënien e një opinionit auditimi mbi performancën financiare të Shoqërisë dhe të rrjedhës së parasë. Si rrjedhim, ne nuk shprehim opinion mbi performancën financiare dhe rrjedhën e parasë.

*Opinion i Kualifikuar i Pozicionit Financiar*

11. Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të diskutuara në paragrafët 7 dhe 9 "Baza për opinion të kualifikuar të pozicionit financiar", pasqyra e pozicionit financiar paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të ARMO Sh.A. më 31 dhjetor 2013 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*Çështje të tjera*

12. Paqyrat Financiare të ARMO Sh.A. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili shprehu një opinion të pakualifikuar në lidhje me këto pasqyra më 9 korrik 2013.

*Deloitte Albania Sh.p.c*

25 prill 2014  
Tiranë, Shqipëri



Elvis Ziu  
Partner Angazhimi

**ARMO Sh.A.**

**Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek)*

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
<b>Aktivët</b>			
Aktive afatgjata materiale	6	52,071,710	80,261,645
Aktive afatgjata jomateriale		4,643	-
Hua dhënë shoqërive të tjera, neto	7	314,528	6,930,617
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>52,390,881</b>	<b>87,192,262</b>
Paradhënie palëve të lidhura	8	943,651	-
Inventari	9	2,324,058	2,122,226
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, neto	10	1,294,786	4,539,446
Aktive të tjera, neto	11	322,398	819,885
Paraja dhe ekuivalentët e saj	12	5,657	18,202
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>4,890,550</b>	<b>7,499,759</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>57,281,431</b>	<b>94,692,021</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali i nënshkruar	13	5,126,461	5,126,461
Rezerva ligjore	14	172,422	172,422
Rezerva të tjera	15	1,744,728	1,744,728
Rezerva nga rivlerësimi i pronave	16	41,761,102	69,012,901
Humbje të mbartura		(39,040,510)	(14,998,229)
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>9,764,203</b>	<b>61,058,283</b>
<b>Detyrimet</b>			
Hua mbartëse të interesit	17	11,257,725	3,879,165
Provizione	18	674,042	-
Detyrime për tatime të shtyra		6,830,482	7,326,633
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>18,762,249</b>	<b>11,205,798</b>
Hua mbartëse të interesit	17	13,169,875	12,106,027
Parapagime		993,989	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera	19	10,297,554	9,027,973
Detyrime të tjera dhe shpenzime të llogaritura	20	4,293,561	1,293,940
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>28,754,979</b>	<b>22,427,940</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>47,517,228</b>	<b>33,633,738</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>57,281,431</b>	<b>94,692,021</b>


Shënimet financiare të bashkangjitura në faqet 8 - 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u aprovuan nga Bordi Mbikqyrës më 31 mars 2014 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Fation Veizaj  
Drejtor i përgjithshëm



Elona Gjika  
Drejtoresh e Financës



**ARMO Sh.A.**

**Pasqyra e Fitimit ose Humbjeve dhe e të Ardhurave të Tjera Përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Të ardhura	21	3,340,711	5,833,699
Kosto e shitjeve	22	(3,433,496)	(5,721,257)
<b>Marzhi bruto</b>		<b>(92,785)</b>	<b>112,442</b>
Të ardhura të tjera	23	152,231	3,099
Amortizimi	24	(3,861,364)	(4,080,334)
Shpenzime personeli	25	(1,506,232)	(1,521,090)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	26	(5,298,234)	(5,562,646)
Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare	27	(9,679,056)	-
Shpenzime provigjoni	28	(674,042)	-
Humbje të tjera	29	(2,479,473)	-
<b>Humbja operative</b>		<b>(23,438,955)</b>	<b>(11,048,529)</b>
Të ardhura/shpenzime financiare	30	(1,225,645)	(1,542,122)
Fitim nga kursi i këmbimit, neto		223,862	146,523
<b>Humbja financiare neto</b>		<b>(1,001,783)</b>	<b>(1,395,599)</b>
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(24,440,738)</b>	<b>(12,444,128)</b>
Tatimi mbi fitimin	31	355,816	378,049
<b>Humbja neto për vitin</b>		<b>(24,084,922)</b>	<b>(12,066,079)</b>
<b><i>Të ardhura / (humbje) të tjera përmbledhëse</i></b>			
<i>Zëra që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje</i>			
Humbje nga rivlerësimi i pronës		(24,189,795)	-
Tatimi mbi fitimin i zërave që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje	31	140,336	-
<b>Të ardhura të tjera përmbledhëse të vitit neto nga tatimi mbi fitimin</b>		<b>(24,049,459)</b>	-
<b>Humbja përmbledhëse e vitit</b>		<b>(48,134,381)</b>	<b>(12,066,079)</b>

Shënimet financiare të bashkangjitura në faqet 8 - 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



**ARMO Sh.A.**

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva nga rivlerësimi i pronave	Rezerva të tjera	Humbje të mbartura	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2012</b>						
(siç është raportuar më parë )	5,126,461	172,422	84,095,406	1,744,728	(5,686,006)	85,453,011
<i>Rregullimet (shih Shënimin 3.14)</i>	-	-	(11,677,561)	-	(651,088)	(12,328,649)
<b>Gjendja më 1 janar 2012 (Ndryshuar)</b>	<b>5,126,461</b>	<b>172,422</b>	<b>72,417,845</b>	<b>1,744,728</b>	<b>(6,337,094)</b>	<b>73,124,362</b>
Humbja e vitit	-	-	-	-	(12,066,079)	(12,066,079)
Humbje të tjera përmbledhëse të vitit neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-	-	-
Transferimi i amortizimit të tepricës së rivlerësimit neto nga tatimi tek rezerva e rivlerësimit	-	-	(3,404,944)	-	3,404,944	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)</b>	<b>5,126,461</b>	<b>172,422</b>	<b>69,012,901</b>	<b>1,744,728</b>	<b>(14,998,229)</b>	<b>61,058,283</b>
Korrigjimi i gabimeve të viteve të mëparshme	-	-	-	-	(3,159,699)	(3,159,699)
Humbja e vitit	-	-	-	-	(24,084,922)	(24,084,922)
Humbje të tjera përmbledhëse të vitit neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	(24,049,459)	-	-	(24,049,459)
Transferimi i amortizimit të tepricës së rivlerësimit neto nga tatimi tek rezerva e rivlerësimit	-	-	(3,202,340)	-	3,202,340	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2013</b>	<b>5,126,461</b>	<b>172,422</b>	<b>41,761,102</b>	<b>1,744,728</b>	<b>(39,040,510)</b>	<b>9,764,203</b>

Shënimet financiare të bashkangjitura në faqet 8 - 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**ARMO Sh.A.**

**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
<b>Aktivitetet operative</b>		
Humbja e vitit	(24,084,922)	(12,066,079)
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin	3,861,364	4,080,336
Humbje nga aktive të nxjerra jashtë përdorimit	106,373	-
Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare	9,679,116	-
Humbje të tjera	2,479,472	-
Shpenzime provigjoni	674,042	-
Shpenzime interesi	1,226,027	-
Të ardhura nga tatim fitimi i njohur në fitim ose humbje	(355,816)	(378,049)
<i>Ndryshime në kapitalin punues:</i>		
(Rritje) / rënie në inventarë	(329,180)	3,808,983
Rënie në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	383,922	4,601,880
Rënie në aktive të tjera	321,902	-
Rritje në parapagime	993,990	20,914
Rritje në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	2,126,909	1,130,054
(Rënie) / rritje në detyrime të tjera	(1,279,913)	791,963
Tatimi mbi fitimin i paguar	-	-
<b>Rrjedha e parasë (përdorur në) / gjeneruar nga aktivitetet operative</b>	<b>(4,196,713)</b>	<b>1,613,536</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerjet neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale	(67,078)	(384,785)
Blerjet neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata jomateriale	(4,644)	121
(Shuma të marra) / pagesa për huatë ndaj shoqërive të tjera	(1,049,906)	10,478,566
Paradhënie palëve të treta	(943,650)	(2,214,886)
<b>Rrjedha e parasë (përdorur në) / gjeneruar nga aktivitetet investuese</b>	<b>(2,065,278)</b>	<b>7,879,016</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Shuma të marra / (pagesa për) hua nga palë të treta dhe banka	7,475,474	(9,598,135)
Interes i paguar	(1,226,028)	-
<b>Rrjedha e parasë gjeneruar nga / (përdorur në) aktivitetet financuese</b>	<b>6,249,446</b>	<b>(9,598,135)</b>
Rënie neto e parasë dhe e ekuivalentëve të saj	(12,545)	(105,583)
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit</b>	<b>12 18,202</b>	<b>123,785</b>
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit mbi paranë dhe ekuivalentët e saj	-	-
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	<b>12 5,657</b>	<b>18,202</b>

Shënimet financiare të bashkangjitura në faqet 8 - 44 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **ARMO Sh.A.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

ARMO Sh.A. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionare shqipëtare e themeluar më 6 prill 1999 me Numër Unik Identifikimi Fiskal J82916498D. ARMO më parë ishte Shoqëri shtetërore për tregëtimin dhe rafinimin e naftës.

85% e aksioneve të Shoqërisë u privatizua në gusht 2008 nga Anika Mercuria Refinery Associated Oil (AMRA Oil). Pjesa e mbetur e aksioneve prej 15% zotërohen nga Qeveria Shqipëtare, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes (ish Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës).

Deri më 6 gusht 2013 80% të aksioneve të AMRA Oil ishin në pronësi të Anika Enterprises SA, dhe 20% në pronësi të Refinery Associates of Texas. Më 6 gusht 2013, aksionet e AMRA Oil u blenë nga Heaney Assets Corp. me adresë Morgan & Morgan, kutia postare nr. 958, Pasea Estate Road Town, Tortola, British Virgin Islands.

Shoqëria është e angazhuar në fushën e përpunimit, rafinimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj. Rafineritë e saj ndodhen në Fier dhe Ballsh. Rafineria e Fierit ka një kapacitet rafinimi prej 500 mijë ton naftë bruto në vit, ndërsa Rafineria e Ballshit ka një kapacitet rafinimi 1,000 mijë ton naftë bruto në vit.

Adresa e regjistruar e drejtimit të Shoqërisë është ABA Center, Kati 8, Rruga "Papa Gjon Pali II", Tiranë, Shqipëri.

### **Drejtimi i Shoqërisë**

Bordi Mbikqyrës përbëhet nga anëtarët si më poshtë:

1. Abe Halati	Kryetar
2. Joseph Nelton Desormeaux	Anëtar
3. Engjell Agaci	Anëtar
4. Valerie Strecker	Anëtar
5. Laurence Storch	Anëtar

Prej 6 gusht 2013 Drejtor i Përgjithshëm është Z. Fatjon Veizaj.

Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria kishte 1,332 punonjës (31 dhjetor 2012: 1,425 punonjës).

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat Financiare u aprovuan për miratim nga Bordi Mbikqyrës më 31 mars 2014.

### **2.2. Bazat e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke respektuar parimin e kostos historike me përjashtim të tokës, ndërtesave, ndërtimeve dhe instalimeve, makinerive dhe paisjeve, paisjeve të zyrës dhe mjeteve të tjera që janë matur me shumat e rivlerësuar në fund të çdo periudhe raportuese, siç shpjegohet në politikat kontabël më poshtë.

### **2.3. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

## **2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)**

### **2.4. Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të kërkon nga Drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në Shënimin 4.

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria.

### **2.5. Baza e vijimësisë**

Pasqyra e pozicionit financiar të Shoqërisë, rrjedha e parasë, pozicioni i likuiditetit dhe huamarrjet janë përshkruar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, duke përfshirë politikat dhe proceset për manaxhimin e kapitalit të saj; objektivat për manaxhimin e rrezikut financiar; detajet e instrumentave të saj financiare; ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit. Në bazë të analizave të kryera më lart, Drejtimi beson se Shoqëria është e mirë-pozicionuar për të manaxhuar me sukses rreziqet e saj të biznesit pavarësisht performancës negative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, e cila lidhet kryesisht me operacione të kaluara. Që nga gushti 2013, Drejtimi ka monitoruar nga afër ekspozimet ndaj rrezikut të kredisë dhe shumica e shitjeve nga ajo datë janë kryer mbi bazën e parapagimit. Nga ana tjetër, nevojat për likuiditet janë plotësuar nëpërmjet financimit bankar, si edhe me mbështetjen e shoqërisë mëmë, e cila ka konfirmuar me anë të një letre mbështetëse gadishmërinë dhe aftësinë për të mbështetur operacionet e Shoqërisë për 12 muajt e ardhshëm pas 31 dhjetorit 2013. Drejtimi i ri ka negociuar me të gjitha bankat me të cilat kishte hua afatgjata dhe ka arritur terma dhe kushte më të mira në lidhje me normat e interesit të huamarrjes dhe datat e shlyerjes. Në shtator 2013 dhe shkurt 2014, ARMO ka nënshkruar dy marrëveshje për shërbime rafinimi me dy Shoqëri nga të cilat synon të sigurojë flukse hyrëse parash të qëndrueshme dhe të sigurta, meqënëse tarifa varet nga shuma e naftës bruto që ARMO do të përpunojë. Drejtimi ka pritshmëri të arsyeshme se Shoqëria ka burime të mjaftueshme për të vazhduar operacionet e saj në të ardhmen. Bazuar në sa më sipër, Drejtimi vlerësoi si të përshtatshme përgatitjen e pasqyrave financiare mbi parimin e vijimësisë.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është kryer transaksioni. Aktivitetet dhe pasivitetet monetare në monedhë të huaj janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën raportimit. Fitimi ose humbja në monedhë të huaj mbi zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës raportuese.

Zërat jo monetarë, të cilët janë matur me kosto historike në monedhë të huaj, janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është kryer transaksioni.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.2. Aktivet afatgjata materiale**

##### *(i) Njohja dhe matja*

Toka, ndërtesa, ndërtimet dhe instalimet, makineritë dhe paisjet, paisjet e zyrës dhe mjete të tjera janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me shuma të rivlerësuara, llogaritur me vlerën e drejtë në datën e rivlerësimit, minus çdo amortizim të akumuluar të mëpasshëm dhe humbje nga zhvlerësimi i akumuluar i mëpasshëm. Rivlerësimet janë kryer me frekuencë të mjaftueshme në mënyrë të tillë që vlerat kontabël neto të mos ndryshojnë materialisht nga ato që do të percaktoheshin nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të çdo periudhe raportuese.

Çdo tepriçë nga rivlerësimi njihet në të ardhurat e tjera përmbledhëse dhe akumulohet në kapitalin aksionar, me përjashtim të rastit kur mbulon uljen e rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në pasqyrën e fitimit ose humbjes, rast në të cilin rritja njihet direkt në fitim ose humbje deri në masën e rënies nga zhvlerësimi të njohur më parë. Rënia në vlerën e mbetur e lindur nga rivlerësimi njihet në fitim ose humbje në masën që kalon balancën e mbajtur në rezervën e rivlerësimit të pronave në lidhje me një rivlerësim të mëparshëm të këtij aktivi, nëse ka.

Mjetet e transportit dhe punimet në proces mbahen me kosto minus humbje nga zhvlerësimi. Kosto përfshin tarifat profesionale dhe për aktivet kualifikuese, kostot e huamarrjes të kapitalizuara në përputhje me politikat kontabël të Shoqërisë.

Prona të tilla klasifikohen në kategori të caktuara të aktiveve afatgjata materiale pasi përfundojnë dhe janë gati për përdorimin e parashikuar. Amortizimi i këtyre aktiveve fillon kur janë gati për përdorimin e tyre të synuar, mbi të njëjtën bazë si aktivet e tjera në pronësi.

Kur pjesë të ndryshme të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato regjistrohen si artikuj të veçantë (përbërës kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Një aktiv afatgjat material çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit ose kur nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i aktivitetit. Çdo fitim ose humbje që lind nga dalja jashtë përdorimit e një zëri të aktiveve afatgjata materiale percaktohet si diferencë ndërmjet shumës së aktivitetit të nxjerrë jashtë përdorimit me vlerën e tij të mbetur dhe njihet në fitim ose humbje.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale (të percaktuara si diferencë e të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të aktivitetit) njihen me vlerën e tyre të mbetur në rezultatin operativ të periudhës.

##### *(ii) Kosto të mëtejshme*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet me vlerën e mbetur kontabël të zërit, nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara brenda pjesës do t'i shkojnë Shoqërisë, dhe kostot e saj mund të maten në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e përditshme të mirëmbajtjes së aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.2 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi shumën e amortizueshme, e cila është kosto e aktivit minus vlerën e mbetur.

Kategoria	Norma e amortizimit
Ndërtesa, ndërtime dhe instalime	5%
Makineri dhe paisje	20%
Mjete transporti	20%
Paisje zyre dhe mjete të tjera	20%-25%

Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Amortizimi i aktiveve në proces fillon kur ato janë të vlefshme për përdorim, p.sh. kur ato janë në vendin dhe kushtet e nevojshme për të funksionuar në mënyrën e synuar nga Drejtimi.

Këto norma pasqyrojnë më nga afër modelin e pritshëm të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të trupëzuara tek aktivet.

Për shitjet e mëpasshme ose nxjerrjet jashtë përdorimit të një aktivi të rivlerësuar, teprica e rivlerësimit që mbetet në rezervën e rivlerësimit të pronave transferohet direkt tek fitimi i pashpërndarë.

Jetëgjatësitë e vlerësuara, vlerat e mbetura dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese, ndersa ndryshimet në këto vlerësime njihen dhe kanë efekt për periudhat e ardhshme.

#### 3.3. Aktivet afatgjata jomateriale

##### (i) Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata jomateriale të blerë më vete fillimisht maten me kosto. Pas njohjes fillestare, aktivet jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka.

##### (ii) Shpenzime të mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilin ai lidhet. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet për vetëgjenerimin e emrit të mirë dhe markave, njihen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktivit minus vlerën e tij të mbetur. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për programet me normë vjetore amortizimi 25% dhe për aktivet e tjera jomateriale me normë vjetore të amortizimit 15%.

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.4. Inventarët

Inventarët paraqiten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e materialeve është kosto e blerjes, duke u bazuar në metodën hyrja e parë – dalja e parë.

Kosto e naftës bruto dhe e produkteve të rafinuara përfshin koston e blerjes, koston e rafinimit, duke përfshirë përqindjen e duhur të amortizimit, shpenzimeve të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe shpenzimet e përgjithshme bazuar në kapacitetin normal operativ, të përcaktuar mbi bazën e metodës mesatare të ponderuar.

Vlera e realizueshme neto e naftës bruto dhe e produkteve të rafinerisë është çmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit, pa koston e përlogaritur të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

#### 3.5. Provigjonet

Provigjonet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje në të shkuarën, për të cilën ka mundësi të nevojiten flukse dalëse burimesh që përfshijnë përfitime ekonomike për të përmbushur detyrimin dhe kur është e mundur përlogaritja e besueshme e shumës së detyrimit.

Nëse efekti është material, provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset monetare të pritshme me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit. Pjesa e çliruar nga skontimi njihet si kosto financiare. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që do të nevojiten flukse dalëse të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provigjonet rimerren.

#### 3.6. Grantet

Grantet nuk njihen derisa ka siguri të arsyeshme se Shoqëria do të zbatojë kushtet e bashkangjitura me to dhe se grantet do të merren. Grantet njihen në fitim ose humbje mbi një bazë sistematike gjatë periudhave në të cilat Shoqëria njih si shpenzime koston e lidhura, të cilat grantet synojnë të kompensojnë. Në mënyrë të veçantë grantet, kushti kryesor i të cilave është që Shoqëria duhet të blejë, ndërtojë ose të fitojë aktive afatgjata, njihen si të ardhura të shtyra në pasqyrën e pozicionit financiar dhe transferohen në fitim ose humbje mbi një bazë sistematike dhe racionale gjatë jetëgjatësisë së aktiveve të lidhura.

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.7. Instrumenta financiarë

##### (i) Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, çdo kosto transaksioni që lidhet me to.

##### (ii) Matje të mëpasshme

###### *Paraja dhe ekuivalentët e saj*

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra bankare që janë lehtësisht të konvertueshme në një sasi të njohur parash dhe i nënshtrohen një rreziku jo material për ndryshimet në vlerë.

###### *Hua dhe llogari të arkëtueshme*

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk kuotohen në një treg aktiv. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme (që përfshijnë llogaritë tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, balancat bankare dhe aktive të tjera) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus rëniet në vlerë.

Të ardhurat nga interesi njihen duke aplikuar normën e interesit efektiv, përveç llogarive të arkëtueshme afatshkurtër ku efekti i skontimit është jomaterial. Llogaritë e arkëtueshme nuk mbartin interes dhe paraqiten me vlerën nominale, minus zbritjet përkatëse nga zhvlerësimi. Shumat e vlerësuar si të parikuperueshme bazohen në jetëgjatësinë e llogarive të arkëtueshme dhe përvojës historike.

###### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Detyrimet afatshkurtra nuk amortizohen. Nuk ka diferenca materiale ndërmjet vlerës së drejtë të llogarive të pagueshme dhe vlerës kontabël neto në fund të vitit.

###### *Huamarrje*

Huamarrjet paraqiten me vlerën e tyre të drejtë, neto nga kosto e transaksionit dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe shpenzime interesi bazuar në normën efektive.

Norma e interesit efektiv është norma që skonton ekzakhtësisht pagesat e ardhshme të parasë përgjatë jetëgjatësisë së pritur të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, një periudhë e shkurtër për vlerën kontabël neto në njohjen fillestare.

###### *Të tjera*

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë paraqiten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbje nga rënia në vlerë.

##### (iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukset e parasë nga aktivet financiare skadojnë, ose kur transferon aktivin financiar dhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet që e shoqërojnë atë tek një palë tjetër. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë të përcaktuara në kontratë skadojnë ose janë anuluar. Ndryshimi ndërmjet vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar njihet në fitim ose humbje.



### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.8. Rënia në vlerë**

##### *(i) Aktivet financiare*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë të aktivit. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se ka ndodhur një rast humbjeje, pas njohjes fillestare të aktivit, dhe se kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e ardhshme të aktivit, i cili mund të matet me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivit financiar, që matet me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë ndërmjet vlerës kontabël neto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv të aktivit. Kur një ngjarje e mëvonshme (p.sh. shlyerja e debitorëve) çon në rënie e humbjes nga zhvlerësimi, kjo rënie rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

##### *(ii) Aktivet jo-financiare*

Vlera kontabël neto e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, me përjashtim të inventarëve dhe aktiveve për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka indikacione për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla, atëherë Shoqëria duhet të çmojë shumën e rikuperueshme të aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet kur vlera kontabël neto e një aktivi është më e madhe se shumata e rikuperueshme e tij. Humbja nga zhvlerësimi njihet në llogarinë e fitimit ose humbjes.

Humbja nga zhvlerësimi njihet kur vlera kontabël neto e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhe se shumata e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare hyrëse të cilat në përgjithësi janë të pavarura nga flukset monetare hyrëse nga aktivet e tjera. Shumata e rikuperueshme e një njësie gjeneruese të parasë ose aktivi është vlera e drejtë minus kostot për shitje ose vlera në përdorim e saj, cilado qoftë më e larta. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontohen në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet që lidhen me aktivin.

Në lidhje me aktivet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe ka patur ndryshime në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar shumën e rikuperueshme.

Nëse një humbje nga rënia në vlerë rimerret, vlera kontabël apo flukset e gjeneruara të parasë do të rriten deri në vlerën e rishikuar të rikuperueshme, duke mos kaluar vlerën e mbartur të aktivit që do të ishte përcaktuar në rast se nuk do të ishte njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë në vitet paraardhëse.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.9. Njohja e të ardhurave**

*(i) Shitja e produkteve*

Shoqëria shet naftë bruto dhe nënproduktet e saj, të cilat përpunohen në rafineritë e Fierit dhe Ballshit. Nënproduktet e naftës përfshijnë gazoil, benzinë, solar, bitum, qymyr koks, naftë virxhine, etj.

Të ardhurat nga shitja e naftës bruto dhe e nënprodukteve të saj njihen kur rreziqet dhe përfitimet e pronësisë i transferohen blerësit, e cila konsiderohet se ndodh kur titulli kalon tek blerësi. Në përgjithësi kjo ndodh kur produkti transferohet fizikisht me anije, një tjetër mekanizëm shpërndarjeje, në pikat e distribucionit ose në pikën e mbërritjes sipas kushteve të kontratës.

*(ii) Të ardhura nga rafinimi*

Të ardhurat nga rafinimi njihen në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara sipas marrëveshjeve përkatëse.

*(iii) Të ardhura nga interesi*

Të ardhurat nga interesi njihen kur interesi maturohet. Të ardhurat nga interesi rrjedhin nga llogaritë rrjedhëse në banka.

#### **3.10. Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

Një plan kontributi i përcaktuar është një plan përfitimi pas-punësimi sipas së cilës një njësi ekonomike paguan kontribute fikse në një njësi të veçantë dhe nuk do të ketë asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar shumën të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensionit në Shqipëri sipas një plani pensioni me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzime të përfitimit të punonjësve në fitim ose humbje në periudhat gjatë të cilave shërbimet kryhen nga punonjësit.

#### **3.11. Pagesat e qirasë**

Pagesat e bëra për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Incentivat e arkëtuara mbi qiranë financiare njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë mbi jetëgjatësinë e saj.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.12. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyren e fitimit ose humbjes përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar ose për t'u marrë mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen e vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si edhe çfarëdo lloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet duke vlerësuar diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për raportim financiar, si dhe vlerës kontabël për qëllime tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndodhin, të cilat Shoqëria pret të rimarrë ose të shlyejë vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj, në fund të periudhës raportuese. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet mbi normat e pritshme të aplikuar mbi diferencat e përkohshme të vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në masën që ekziston mundësia që fitimi i tatueshem do të jetë i mundshëm. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen deri në shkallën ku nuk është më e mundur që të realizohet përfitimi përkatës.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore edhe pjesën shtesë të taksave apo interesave për tu paguar. Shoqëria mendon se detyrimet tatimore të llogaritura janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e shumë faktorëve, duke përfshirë interpretime të ligjit tatimor dhe ekperiencën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacioni i ri i vlefshëm mund të çojë që Shoqëria të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore ndikojnë në shpenzimin e tatimit të periudhës kur është bërë një përcaktim i tillë.

#### **3.13. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara**

##### **3.13.1. Standarde dhe interpretime në fuqi në periudhën raportuese**

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale. Me përjashtim të standardit të ri SNRF 13 “Matja e vlerës së drejtë” dhe Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”, aplikimi i të gjithë standardeve të tjera të reja dhe ndryshimeve të standardeve dhe interpretimeve ekzistuese, nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Shoqërisë dhe nuk ndikon në pasqyrat financiare të saj.

- **SNRF 10 “Pasqyrat financiare”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNK 27 (rishikuar në 2011) “Pasqyrat financiare individuale”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **SNK 28 (rishikuar në 2011) “Investime në filial dhe shoqëri të përbashkëta”** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **3.13. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**

##### **3.13.1. Standarde dhe interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)**

- **Ndryshime në SNRF 7 “Instrumentat financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese”** – Netimi i aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyra financiare të konsoliduara”, SNRF 11 “Marrëveshje të përbashkëta” dhe SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera”** – Udhëzime për tranzicionin (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në SNK 19 “Përfitimet e punonjësve”** – Përmirësime të kontabilizimit për përfitimet pas punësimit të punonjësve (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **Ndryshime në standarde të ndryshme “Përmirësime në SNRF-të (cikli 2009-2011)”** që rezultojnë nga projekti i përmirësimeve vjetore të SNRF-ve (SNRF 1, SNK 1, SNK 16, SNK 32, SNK 34) së pari me qëllimin për të hequr paqëndrueshmëritë dhe qartësuar të shprehurin (ndryshimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- **KIRFN 20 “Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqe miniere”** efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

##### **SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë**

Shoqëria ka aplikuar SNRF 13 për herë të parë në vitin aktual. SNRF 13 krijon një burim të vetëm udhëzimi për matjen dhe paraqitjen e vlerës së drejtë. Qëllimi i SNRF 13 është i gjërë; kërkesat për matjen e vlerës së drejtë të SNRF 13 aplikohen si për zërat e instrumentave financiare dhe për ato jo-financiare për të cilat SNRF të tjera kërkojnë ose lejojnë matjen dhe paraqitjen e vlerës së drejtë, me përjashtim të pagesave nëpërmjet aksioneve që është objekt i SNRF 2 “Pagesat e bazuara në aksione”, transaksionet e qirasë që janë brenda objektit të SNRF 17 “Qiratë financiare”, dhe matjet që kanë ngjashmëri me vlerën e drejtë por nuk janë vlera të drejta (p.sh. vlera neto e realizueshme për qëllime të matjes së inventarit ose vlera në përdorim për qëllime vlerësimi të rënies në vlerë).

SNRF 13 e përkufizon vlerën e drejtë si çmimi që do të merrej për shitjen e një aktivi, ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në tregun kryesor (ose më të favorshëm), në datën e matjes, në kushtet aktuale të tregut. Vlera e drejtë sipas SNRF 13 është çmimi dalës pa marrë parasysh nëse çmimi është në mënyrë të drejtpërdrejtë i dukshëm apo i vlerësuar duke përdorur teknika të tjera vlerësimi. Gjithashtu SNRF 13 përfshin dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë.

SNRF 13 kërkon zbatimin e tij nga data 1 janar 2013. Përveç kësaj, subjekteve u janë dhënë dispozita specifike kalimtare, të tilla që të mos kenë nevojë të zbatojnë kërkesat për dhënie informacioni shpjegues të përcaktuara në Standard në informacionin krahasues të siguruar për periudha para zbatimit fillestar të Standardit. Në përputhje me këto dispozita kalimtare, Shoqëria nuk ka përpiluar asnjë dhënie informacioni shpjegues të ri të kërkuar nga SNRF 13 për periudhën krahasuese. Përveç informacioneve shpjeguese shtesë, zbatimi i SNRF 13 nuk ka pasur ndikim material në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.13. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)

##### 3.13.1. Standarde dhe interpretime në fuqi në periudhën raportuese (vazhdim)

###### Ndryshim në SNK 1 Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse

Kompania ka aplikuar ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse" për herë të parë në vitin aktual. Ndryshimi paraqet terminologji të re, përdorimi i të cilit nuk është i detyrueshëm, për pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse. Sipas ndryshimeve në SNK 1, "pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse" është riemëruar si "pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera përmbledhëse" dhe "pasqyra e të ardhurave" është riemëruar si "pasqyra e fitimit ose humbjes".

Megjithatë, ndryshimet në SNK 1 kërkojnë elementë të tjerë të të ardhurave përmbledhëse për t'u shoqëruar në dy kategori në seksionin e të ardhurave të tjera përmbledhëse:

- (a) zëra që nuk do të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje dhe
- (b) zëra që mund të klasifikohen më pas në fitim ose humbje kur plotësohen kushte të caktuara.

Tatimi mbi fitimin mbi zërat e të ardhurave të tjera përmbledhëse kërkohet që të ndahet mbi baza të njëjta – amendimet nuk ndryshojnë mundësinë për të paraqitur zëra të të ardhurave të tjera përmbledhëse para ose pas tatimit. Ndryshimet janë aplikuar në mënyrë retrospektive, dhe kështu paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse nuk është modifikuar, meqë nuk ka ndryshime të rëndësishme që duhet të reflektohen në pasqyrat financiare.

Aplikimi i ndryshimeve të SNK 1 nuk rezulton të ketë ndikim në fitim ose humbje, në të ardhura të tjera përmbledhëse dhe në totalin e të ardhurave përmbledhëse.

##### 3.13.2. Standarde dhe interpretime në publikim por ende jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma jo në fuqi:

- **SNRF 9 "Instrumentat financiare" dhe ndryshime të mëpasshme** (data efektive nuk është përcaktuar ende),
- **SNRF 14 "Llogari të shtyra rregullatore"** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyra financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" and SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** – Njësi investuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** – Përmirësimet të kontabilizimit për përfitimet pas punësimit të punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në SNK 32 "Instrumentat Financiare: Paraqitja"** – Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 36 "Rënia në vlerë e aktiveve"** – Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 39 "Instrumentat financiare: Njohja dhe Matja"** – Novacioni i derivativeve dhe vazhdimësia e kontabilitetit mbrojtës (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),

ARMO Sh.A.

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

**3.13. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara (vazhdim)**

**3.13.2. Standarde dhe interpretime në publikim por ende jo në fuqi (vazhdim)**

- **Ndryshime në standarde të ndryshme “Përmirësime në SNRF-të (cikli 2010-2012)”** që rezultojnë nga projekti i përmirësimeve vjetore të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) së pari me qëllimin për të hequr paqëndrueshmëritë dhe qartësuar të shprehurin (ndryshimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në standarde të ndryshme “Përmirësime në SNRF-të (cikli 2011-2013)”** që rezultojnë nga projekti i përmirësimeve vjetore të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 and SNK 40) së pari me qëllimin për të hequr paqëndrueshmëritë dhe qartësuar të shprehurin (ndryshimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2014),
- **KIRFN 21 “Sekuestrime”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014).

Shoqëria ka zgjedhur të mos aplikojë keto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon se aplikimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e saj financiare në periudhën e aplikimit fillestar.

**3.14. Informacion krahasues**

Informacioni krahasues paraqitet vazhdimisht duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë. Kur është e nevojshme, shumat të caktuara në pasqyrat financiare të vitit të kaluar riklasifikohen për t’iu përshtatur paraqitjes së vitit aktual.

Ka patur një ndryshim në paraqitjen e balancës së llogarive të arkëtueshme paraqitur si më poshtë:

- Hua të dhëna AMRA Sh.A, Taci Oil Sh.A. Kuid Sh.A. në shumën 6,930,617 mijë Lek u riklasifikuan nga llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera në hua ndaj shoqërive të tjera.
- Të arkëtueshmet nga Petrol Alba Sh.A, Debitorë të tjerë, Zbritje të debitorëve të tjerë për shumën 254,951 mijë Lek u riklasifikuan nga llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera në aktive të tjera.
- TVSH e zbritshme në shumën 709,589 mijë Lek u riklasifikua nga llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera në aktive të tjera.
- Garancitë në shumën 57,772 mijë Lek u riklasifikuan nga paraja dhe ekuivalentët e saj në aktive të tjera.
- Investime në ARCO për shumën 900 mijë Lek u riklasifikuan nga Investime në aktive të tjera.
- Komisione disbursimi të huave për shumën 17,306 mijë Lek u riklasifikuan nga aktive të tjera në huatë mbartëse të interesit.

ARMO Sh.A.

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**

**3.14. Informacion krahasues (vazhdim)**

Korrigjim i gabimeve të vitit të mëparshëm

*Inventarët*

Gjatë vitit 2013, Shoqëria zbuloi mospërputhje ndërmjet inventarëve në sistemin kontabël dhe inventarëve sipas proces verbaleve më 31 dhjetor 2012. Nga shqyrtimi i proces verbaleve u vu re se inventarët ishin përdorur për funksionimin e rafinerisë gjatë vitit 2012. Pasqyrat financiare të 2012 janë rishikuar për të korrigjuar këtë gabim. Efekti i riparaqitjes së këtyre pasqyrave financiare është përmbledhur si më poshtë:

Efekti për vitin e mbyllur  
më 31 dhjetor 2012  
Në '000 Lek

Debi: Shpenzime të përgjithshme dhe administrative 2,242,032  
Kredi: Inventarë (2,242,032)

*Shpenzimi i amortizimit*

Gjatë vitit 2013, Shoqëria zbuloi se shpenzimi i amortizimit nuk ishte llogaritur për aktivet afatgjata materiale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 dhe 2011. Pasqyrat financiare të 2012 janë rishikuar për të korrigjuar këtë gabim. Efekti i riparaqitjes së këtyre pasqyrave financiare është përmbledhur si më poshtë:

Efekti për vitin e mbyllur  
më 31 dhjetor 2012  
Në '000 LEK

Debi: Humbja e akumuluar 3,972,878  
Debi: Shpenzim amortizimi 4,080,335  
Kredi: Amortizim i akumuluar (8,053,213)

*Detyrime për tatime të shtyra*

Shoqëria zbuloi se detyrimi për tatimet e shtyra nuk ishin njohur në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011. Diferenca ndërmjet vlerës kontabël neto të aktivitetit të rivlerësuar dhe bazës tatimore të tij është një diferencë e përkohshme e cila çon në lindjen e aktivitetit ose detyrimit për tatim të shtyrë. Pasqyrat financiare të 2012 janë rishikuar për të korrigjuar këtë gabim. Efekti i riparaqitjes së këtyre pasqyrave financiare është përmbledhur si më poshtë:

Efekti në balancën hapëse  
më 1 janar 2012  
Në '000 Lek

Debi: Rezerva nga rivlerësimi në të ardhurat e tjera përmbledhëse 8,101,970  
Kredi: Detyrim për tatimin e shtyrë (8,101,970)  
Transferimi i amortizimit të tepricave nga rivlerësimi neto nga tatimi  
Debi: Rezerva nga rivlerësimi 3,575,590  
Kredi: Humbje të mbartura (3,575,590)

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)****3.14. Informacion krahasues (vazhdim)**

Korrigjim i gabimeve të vitit të mëparshëm (vazhdim)

Efekti në balancën mbyllëse  
më 31 dhjetor 2012  
Në '000 Lek

Njohja e tatimit të shtyrë nga rivlerësimi i aktiveve	
Debi: Detyrim për tatimin e shtyrë	378,049
Kredi: Shpenzim për tatimin e shtyrë	(378,049)
Transferimi i amortizimit të tepricave nga rivlerësimi neto nga tatimi	
Debi: Rezerva nga rivlerësimi	3,404,945
Kredi: Humbje të mbartura	(3,404,945)

*Penalitetet*

Gjatë vitit 2013, Shoqëria zbuloi se penalitetet e lëshuara nga autoritetet tatimore nuk ishin regjistruar në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2012. Pasqyrat financiare të viti 2012 janë rishikuar për të korrigjuar këtë gabim. Efekti i riparaqitjes së këtyre pasqyrave financiare është përmbledhur si më poshtë:

Efekti për vitin e mbyllur  
më 31 dhjetor 2012  
Në '000 Lek

Debi: Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	364,392
Kredi: Tvsh e zbritshme	(261,286)
Kredi: Detyrime të tjera	(103,106)

*Llogari të pagueshme*

Gjatë vitit 2013, Shoqëria zbuloi se detyrimet e lindura në 2009 nuk ishin kontabilizuar në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2012. Pasqyrat financiare të 2012 janë rishikuar për të korrigjuar këtë gabim. Efekti i riparaqitjes së këtyre pasqyrave financiare është përmbledhur si më poshtë:

Efekti në balancën hapëse  
më 1 janar 2012  
Në '000 Lek

Debi: Humbja e mbartur	651,088
Kredi: Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	(651,088)



**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumatat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)****3.14. Informacion krahasues (vazhdim)**

Efekti neto i të gjitha gabimeve të korrigjuar më sipër më 31 dhjetor 2012 paraqitet më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2012	Më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
<i>Pasqyra e pozicionit financiar</i>		
Aktive afatgjata materiale	88,314,859	80,261,645
Inventarë	4,364,258	2,122,226
Aktive të tjera	1,080,272	819,885
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>93,759,389</b>	<b>83,203,756</b>
Humbje të mbartura	(11,443,375)	(14,347,141)
Rezerva nga rivlerësimi	84,095,406	69,012,901
Detyrimi për tatimin e shtyrë	-	7,326,633
<i>Pasqyra e fitimit ose humbjes</i>		
Shpenzime amortizimi	-	(4,080,336)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	(3,221,000)	(5,562,646)
Ndryshime në tatimin e shtyrë	-	376,466
Humbja e periudhës	(5,757,369)	(12,066,079)

Të gjitha transaksionet e mësipërme nuk ndikojnë në shpenzimin e tatim fitimit.

**4. VLERËSIMET KRITIKE KONTABËL DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURIVE TË VLERËSIMEVE**

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë mbi ngjarje të ardhshme, të cilat mendohen të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël rrallë herë barazojnë rezultatet aktuale të lidhura me to. Vlerësimet dhe supozimet që kanë rreziqe të konsiderueshme në lindjen e rregullimeve materiale të vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar më poshtë.

*Rënia në vlerë e aktiveve financiare (huadhënie, llogari të arkëtueshme)*

Shoqëria rishikon aktivet e saj financiare për të vlerësuar rregullisht rënien në vlerë. Për të përcaktuar nëse humbja nga rënia në vlerë duhet ose jo të regjistrohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes, Drejtimi vlerëson nëse ka të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme të flukseve monetare të ardhshme të llogarive të arkëtueshme. Këto evidenca mund të përfshijnë të dhëna të dallueshme që tregojnë se ka patur një ndryshim të kundërt në statusin e pagesave të debitorëve, ose të kushteve ekonomike lokale ose kombëtare që ndërlidhen me mungesat në aktivet e Shoqërisë.

Drejtimi përdor vlerësime bazuar në përvojën historike për humbjet në aktive me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe të dhëna objektive për zhvlerësim të ngjashme me ato në portofole kur skedulohen flukset e parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura si për vlerësimin e shumëve ashtu edhe të kohëzgjatjes së flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht për të reduktuar çdo diferencë ndërmjet humbjes së vlerësuar dhe humbjes aktuale.

**ARMO Sh.A.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

#### **4. VLERËSIMET KRITIKE KONTABËL DHE BURIMET KRYESORE TË PASIGURIVE TË VLERËSIMEVE (VAZHDIM)**

*Vlerësimi i jetëgjatësisë së aktiveve afatgjata materiale*

Siç përshkruhet më sipër në shënimin 3.2 (iii) Shoqëria rishikon vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve afatgjata materiale në fund të çdo periudhe raportuese. Jetëgjatësitë e aktiveve bazohen në përvojën historike për aktive të ngjashme si edhe në ngjarje të pritshme në të ardhmen, të cilat mund të ndikojnë jetën e tyre, të tilla si ndryshimet teknologjike.

*Tatim fitimi*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Përcaktimi i vlerës së tatimit mbi fitimin e shtyrë kërkon gjykime të rëndësishme. Ekzistojnë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi aktual tatimor është i pasigurtë. Kur rezultati përfundimtar tatimor i këtyre çështjeve ndryshon nga shuma fillestare e regjistruar, ndryshime të tilla ndikojnë në aktivet dhe detyrimet për tatim fitimin e shtyrë në periudhën në të cilën është bërë përcaktimi.

*Matja e vlerës së drejtë dhe procesi i vlerësimit*

Aktivët afatgjata materiale të Shoqërisë maten me vlerën e drejtë për qëllime të raportimit financiar. Drejtimi i Shoqërisë caktoi një shoqëri vlerësimi të pavarur të kualifikuar për të kryer procesin e vlerësimit. Të dhënat rreth teknikave të vlerësimit dhe faktorëve të përdorur për të përcaktuar vlerën e drejtë të aktiveve afatgjata materiale paraqiten në Shënimin 6.

*Testimi i rënies në vlerë të aktiveve afatgjata materiale*

Duke patur parasysh përdorimin e Kostos e Zëvendësimit së Amortizuar (KZA) në vlerësimin e ndërtesave, makinerive dhe paisjeve, ka rrezik që vlera e këtyre aktiveve mund të jetë më e madhe se shuma e rikuperueshme. KZA bazohet në koston e riprodhimit, ndërsa humbjet nga rënia në vlerë maten duke iu referuar flukseve monetare të ardhshme dhe çmimit të shitjes.

#### **5. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR**

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Shoqërinë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut. Shënime të tjera shpjeguese janë përfshirë në këto pasqyra financiare.

Drejtimi ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat dhe procedurat e manaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë në një proces zhvillimi të vazhdueshëm që nga momenti kur drejtimi i ri i Shoqërisë mori përsipër aktivitetin më 6 gusht 2013. Drejtimi i ri ka për qëllim krijimin e një sërë politikash dhe praktikash për manaxhimin e rreziqeve, të cilat do jenë subjekt i miratimit final nga Bordi Mbikqyrës.

Rreziqet kryesore të identifikuara dhe që mund të ndikojnë negativisht në aktivet financiare, detyrimet ose flukset e ardhshme të pasasë të Shoqërisë janë: rreziku i tregut që përfshin rrezikun e çmimit të produkteve, rreziku i normës së interesit të flukseve monetare dhe rreziku i këmbimit valutor; rreziku i likuiditetit; dhe rreziku i kreditimit.

## **5. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

### **(a) Rreziku i kreditimit**

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga ky instrument.

Që nga ndryshimi i drejtimit të Shoqërisë më 6 gusht 2013, Shoqëria ka vendosur praktika të reja mbi shitjet me kredi, sipas të cilave shitjet në pika të caktuara brenda vendit kryhen me parapagim, ndërsa për eksportet ose shitjet brenda vendit bazuar në kontrata afatgjatë realizohen nepërmjet letrave të kreditit. Përveç kësaj, gjendjet e llogarive të arkëtueshme monitorohen në mënyrë të vazhdueshme, duke bërë që ekspozimi i Shoqërisë pas 6 gushtit 2013 të mos jetë i konsiderueshëm.

Ekspozimi i kreditit, i trashëguar nga veprimet para 6 gushtit 2013, është analizuar dhe testuar për zhvlerësim mbi baza individuale. Siç raportohet dhe në shënimin 7, të gjitha huatë e dhëna palëve të treta, të cilat para 6 gushtit 2013 ishin kategorizuar si palë të lidhura, u zhvlerësuan tërësisht.

Përsa i përket rrezikut të kreditit që vjen nga aktivet financiare të Shoqërisë, e cila përbëhet nga mjetet monetare, llogaritë e arkëtueshme dhe huatë e dhëna palëve të treta, ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit vjen nga mospagimi nga pala tjetër, me një ekspozim maksimal të barabartë me vlerën kontabël neto të këtyre instrumentave. Rreziku i kreditit paraqitet në Shënimin 33.1.

### **(b) Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të ndeshet me vështirësi në përmbushjen e angazhimeve të shoqëruara me instrumenta financiare. Drejtimi i ri i Shoqërisë monitoron rrezikun e likuiditetit për t'u siguruar që do të ketë vazhdimisht fonde të mjaftueshme për të shlyer detyrimet e saj kur nevojitet. Objektivi i Shoqërisë është të mbajë një ekuilibër midis vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit nëpërmjet përdorimit të huave bankare dhe overdrafteve.

### **(c) Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar të luhetet si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut. Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziqesh: rreziku i çmimit të produkteve, rreziku i normave të interesit dhe rreziku i këmbimit valutor.

#### *(i) Rreziku nga çmimet e produkteve*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të luhatjeve në çmimet e produkteve mbizotëruese në treg në llojet e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. Politika e Shoqërisë është të manaxhojë këto rreziqe nëpërmjet përdorimit të kontratave me çmime të indeksuara. Shoqëria lidh kontrata për blerjen e mallrave në rrjedhën normale të biznesit. Këto kontrata nuk janë derivativë dhe trajtohen si kontrata përmbarese, të cilat njihen dhe maten me kosto në momentin kur ndodh transaksioni.

#### *(ii) Rreziku nga normat e interesit*

Rreziku i normave të interesit përbehet nga rreziku që vlera e flukseve monetare të ardhshme e instrumentave financiare do të ndryshojë si rezultat i ndryshimeve në normën e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut është shumë i kufizuar meqënëse pjesa më e madhe e detyrimeve afatgjata është kontraktuar me norma interesi fikse.

#### *(iii) Rreziku i këmbimit valutor*

Rreziku i këmbimit valutor është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet nga ndryshimet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës përmes transaksioneve në monedhë të huaj të cilat lindin nga shitjet, blerjet ose huatë në monedhë të huaj.

Armo Sh.A.

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE, NETO**

Aktivitet afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

	<b>Toka</b>	<b>Ndërtesa, ndërtime dhe instalime</b>	<b>Makinieri dhe paisje</b>	<b>Paisje zyre dhe të tjera</b>	<b>Punime në proçes</b>	<b>Mjete transporti</b>	<b>TOTALI</b>
<b>Kosto ose rivlerësimi</b>							
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>							
(Ndryshuar)	3,676,138	2,522,834	81,936,080	101,142	84,908	132,846	88,453,948
Shtesa	-	3,863	46,281	8,738	2,106	6,090	67,078
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(99,481)	-	(165)	(21,549)	(84,659)	(205,854)
Transferime	-	1,633	-	257	(1,890)	-	-
Rregullime nga rivlerësimi	(197,835)	(421,910)	(35,538,301)	(59,540)	-	(25,876)	(36,243,462)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2013</b>	<b>3,478,303</b>	<b>2,006,939</b>	<b>46,444,060</b>	<b>50,432</b>	<b>63,575</b>	<b>28,401</b>	<b>52,071,710</b>
<b>Amortizim i akumuluar</b>							
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>							
(Ndryshuar)	-	(333,293)	(7,784,884)	(44,079)	-	(30,047)	(8,192,303)
Amortizimi i vitit	-	(107,224)	(3,725,580)	(12,171)	-	(16,389)	(3,861,364)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Rregullime nga rivlerësimi	-	440,517	11,510,464	56,250	-	46,436	12,053,667
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2013</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>							
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>3,676,138</b>	<b>2,189,541</b>	<b>74,151,196</b>	<b>57,063</b>	<b>84,908</b>	<b>102,799</b>	<b>80,261,645</b>
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>3,478,303</b>	<b>2,006,939</b>	<b>46,444,060</b>	<b>50,432</b>	<b>63,575</b>	<b>28,401</b>	<b>52,071,710</b>

Amortizimi i akumuluar është eliminuar përkundrejt vlerës kontabël bruto të aktivitet dhe vlerës neto të riparuar me vlerën e rivlerësuar të tij.

## 6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE, NETO (VAZHDIM)

### 6.1. *Matja e vlerës së drejtë të tokës, ndërtesave, ndërtimeve dhe instalimeve, makinerive dhe paisjeve dhe mjeteve të tjera*

Për të përcaktuar vlerën e drejtë të tokës, ndërtesave, ndërtimeve dhe instalimeve, makinerive dhe paisjeve, dhe mjeteve të tjera të Shoqërisë është kryer një vlerësim i pavarur i të tyre më 31 dhjetor 2013. Nivele të ndryshme të faktorëve të përdorur në metodat e vlerësimit janë përcaktuar si më poshtë:

- Çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta (Niveli 1).
- Të dhëna të tjera, përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në nivelin 1, që janë të evidentueshëm për aktivin ose pasivin, qoftë drejtpërdrejtë (siç janë çmimet) apo tërthorazi (që rrjedhin nga çmimet) (Niveli 2).
- Të dhëna për aktive ose detyrime të cilat nuk bazohen në të dhëna të verifikueshme të tregut (faktorë jo të vëzhgueshëm) (Niveli 3).

### 6.2. *Teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë të aktiveve në nivelin 2.*

Për të matur vlerën e drejtë të tokës është përdorur metoda e tregut. Brenda metodës së tregut, metoda kryesore e përdorur për vlerësimin e pasurive të patundshme ka qenë metoda e krahasimit të tregut duke konsideruar përdorimin më të lartë dhe më të mirë të çdo prone.

Faktorët e përdorur në llogaritjen e vlerës së drejtë për tokën janë kategorizuar në nivelin 2 dhe janë nxjerrë duke përdorur çmimet e shitjes të tokëve së ngjashme, në afërsi të pronës, e cila është subjekt vlerësimi, të rregulluar për ndryshime kyçe të tilla si madhësia e pronës dhe pozicionimi.

Për shkak të evidencave të kufizuara të transaksioneve të shitjes të tokave të ngjashme në afërsi të tokave në të cilën ndodhet Rafineria e Ballshit, Termocentrali i Ballshit dhe Rafineria e Fierit, si transaksione të krahasueshme, u morën në konsideratë transaksionet për shitjen e tokës industriale në rajone të tjera të Shqipërisë dhe u verifikuan me transaksione të ngjashme në vendet fqinje. Faktorët e tjerë rregullues, që u morën në konsideratë në përcaktimin e çmimit për metër katror, ishin madhësia e pronës, vendndodhja e saj krahasuar me qendrat e urbanizuara, infrastruktura përreth, etj.

Faktori më i rëndësishëm në këtë metodë vlerësimi është çmimi për metër katror.

### 6.3. *Teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë të aktiveve në nivelin 3*

#### (i) *Vlerësimi i ndërtimeve dhe instalimeve*

Duke pasur parasysh natyrën specifike të ndërtesave dhe strukturave të tjera të ndërtimit, vlerësuesit konsideruan që metoda më e mirë për t'u përdorur ishte metoda e kostos dhe më konkretisht Kosto e Zëvendësimit e Amortizuar. Vlerësuesit përdorën koston për metër katror të strukturave të ngjashme të ndërtimit, për të vlerësuar koston e zëvendësimit, e cila u rregulluar edhe ndaj çdo ndryshimi të mundshme strukturor dhe amortizimi normal nga konsumi, në mënyrë që të arrihej në koston e zëvendësimit të amortizuar. Vlerësimi i koston së zëvendësimit iu referua kostove të ndërtimit të vlerësuar nga shoqëri lokale ndërtimi dhe Manualit të Kostove të Ndërtimit për vitin 2013 të publikuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

#### (ii) *Vlerësimi i makinerive dhe paisjeve*

Makineritë dhe pajisjet e ARMO-s janë të një natyre të specializuar dhe për këtë arsye, metoda më e përshtatshme për vlerësimin e vlerës së drejtë të tyre ishte metoda e kostos duke përdorur metodën e Kostos e Zëvendësimit e Amortizuar (KZA).

## 6. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

### 6.3. Teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë të aktiveve në nivelin 3 (vazhdim)

#### (ii) Vlerësimi i makinerive dhe pajisjeve (vazhdim)

Në mënyrë që të vlerësohet KZA e makinerive dhe pajisjeve fillimisht është vlerësuar kosto e re e zëvendësimit. Kosto e re e zëvendësimit është përcaktuar si shuma e vlerësuar e nevojshme për të zëvendësuar të gjitha makineritë dhe pajisjet në të njëjtën kohë, duke përdorur teknologjinë më bashkëkohore, dhe përfshirë koston e materialeve të ndërtimit, të punës, pajisje të prodhuara, shpenzime dhe fitimi për kontraktorin, dhe tarifë; por pa provigjonuar orët e punës jashtë orarit, bonuse për punën, apo blerjen e materialeve dhe pajisjeve të tjera.

Faktori më i rëndësishëm është kosto e re e zëvendësimit për kapacitete rafinimi të fuçive ditore të naftës bruto me struktura të ngjashme me ato në Ballsh dhe Fier, të cilat janë rregulluar për veçoritë e rafinerive të përmendura.

Nga sa më sipër u zbriten zhvlerësimet fizike dhe funksionale, në mënyrë që të arrihej tek Kosto e Zëvendësimit e Amortizuar, nga e cila më pas zbritet vlera e drejtë e tokës dhe e ndërtesave në mënyrë që të arrihet tek vlera e makinerive dhe pajisjeve.

### 6.4. Testi i rënies në vlerë

Më 31 dhjetor 2013 testi i rënies në vlerë u krye për të vlerësuar vlerën në përdorim të aktiveve të shoqërisë. Duke pasur parasysh përdorimin e KAZ-së në vlerësimin e ndërtesave dhe makinerive dhe pajisjeve, ekziston rreziku që vlera e këtyre aktiveve mund të tejkalojë shumën e rikuperueshme. KAZ bazohet në koston e riprodhimit, ndërkohë që humbjet nga rënia në vlerë maten duke ju referuar flukseve të ardhshme monetare dhe çmimeve të shitjes. Sipas SNK 36, humbja nga rënia në vlerë është shuma me të cilën vlera kontabël neto e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e rafinerive më 31 dhjetor 2013 është përcaktuar në bazë të llogaritjes së vlerës në përdorim duke iu bazuar parashikimeve të flukseve monetare nga buxhetet financiare të miratuara nga drejtimi dhe që mbulon një periudhë pesë vjeçare. Norma e skontimit para tatimit, e zbatuar në parashikimin e flukseve të mjeteve monetare është 11.2%, dhe flukset monetare përtej periudhës pesë vjeçare janë mbajtur në një nivel të krahasueshëm me vitin e pestë. Si rezultat i analizës, nuk u identifikua asnjë rënie në vlerë për këto rafineri.

Supozimet kryesore të përdorura përfshijnë:

- Çmimet e shitjes për nënproduktet e naftës bruto për Rafinerinë e Ballshit
- Çmimet e naftës bruto për Rafinerinë e Ballshit
- Kostot e rafinimit për Rafinerinë e Fierit
- Normat e skontimit

Çmimet e shitjes për nënproduktet e naftës bruto: Parashikimi për çmimet e produkteve u bazuan në vlerësimet e drejtimit dhe të dhënave në dispozicion nga tregu.

Çmimet e naftës bruto: Parashikimi për çmimet e produkteve u bazua në vlerësimet e drejtimit dhe të dhënave në dispozicion nga tregu.

Kostot e rafinimit: Kostot e rafinimit u bazuan në të dhënat historike dhe kërkesat teknologjike të rafinerisë së Fierit.

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***7. HUA DHËNË SHOQËRIVE TË TJERA, NETO**

Huatë ndaj shoqërive të tjera janë të detajuara si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Më 31 dhjetor 2012</b> (Ndryshuar)
Taci Oil ITSC	6,453,109	6,128,118
KUID Sh.A.	449,232	478,919
AMRA Oil	314,528	323,580
Provigjione për huatë ndaj shoqërive të tjera	(6,902,341)	-
<b>Totali</b>	<b>314,528</b>	<b>6,930,617</b>

Hua ndaj palëve të lidhura përfaqësojnë hua pa interes ndaj AMRA Oil me afat të pacaktuar.

Huatë e dhëna Taci Oil International Trading and Supply Company Sh.A. (Taci Oil ITSC) dhe KUID Sh.A. janë disbursuar para datës së ndryshimit të strukturës së aksionarëve. Për shkak të problemeve financiare të rëndësishme të këtyre dy shoqërive, drejtimi krijoi një provigjion për të gjithë shumën e huasë pavarësisht se drejtimi është i angazhuar t'i mbledhur këto shuma në të ardhmen.

**8. PARADHËNIE PALËVE TË LIDHURA**

Paradhëniet ndaj palëve të lidhura përfaqësojnë një paradhënie afatshkurtër dhënë Heaney Assets Corp. Paradhëniet janë pa interes dhe me maturitet të pacaktuar.

**9. INVENTARI**

Inventari përbëhet si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Më 31 dhjetor 2012</b> (Ndryshuar)
Lëndë e parë		
Naftë bruto	362,291	274,649
Kimikate	123,329	-
Solar	121,819	-
Lëndë të para të tjera	7,027	50,095
Prodhim në proces		
Prodhim në proces	303,125	111,913
Produkte të gatshme		
Virgin Nafta	182,729	117,571
Solar - Nënprodukt	179,005	90,237
Mazut - Nënprodukt	72,701	15,823
Nënprodukte të tjera	46,315	252,013
Inventarë të tjerë	925,717	1,209,925
<b>Total</b>	<b>2,324,058</b>	<b>2,122,226</b>

Inventarë të tjerë përfshijnë produkte të tilla si katalizatorë, sodë kaustike, tuba dhe produkte të tjera të përdorura në procesin e rafinimit.

**ARMO Sh.A.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**10. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA, NETO**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare përbëhen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Më 31 dhjetor 2013</b> (Ndryshuar)
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	4,173,729	4,834,810
Provizjion për llogaritë e arkëtueshme	<u>(2,878,943)</u>	<u>(295,364)</u>
<b>Totali</b>	<b><u>1,294,786</u></b>	<b><u>4,539,446</u></b>

Shoqëria ka njohur provigjone 100% ndaj atyre llogarive të arkëtueshme tregtare për të cilat nuk pret t'i arkëtojë.

Analiza e vjetërsisë për llogaritë e arkëtueshme me vonesa në pagesa por jo të provigjionuara:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>
0 - 90 ditë	85,275
90 - 180 ditë	84,659
Mbi 180 ditë	<u>1,124, 852</u>
<b>Totali</b>	<b><u>1,294,786</u></b>

Lëvizjet në provigjionet e llogarive të arkëtueshme janë si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Më 31 dhjetor 2012</b> (Ndryshuar)
Gjendja në fillim të vitit	295,364	-
Provizjone për llogaritë e arkëtueshme	<u>2,583,579</u>	<u>295,364</u>
<b>Totali</b>	<b><u>2,878,943</u></b>	<b><u>295,364</u></b>

Për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme të llogarive të arkëtueshme tregtare, Shoqëria mori në konsideratë çdo ndryshim në cilësinë e kreditimit të llogarive të arkëtueshme nga data fillestare e krijimit deri në fund të periudhës raportuese.



**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***11. AKTIVE TË TJERA, NETO**

Aktivet e tjera përbëhen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Më 31 dhjetor 2012</b> (Ndryshuar)
Aktive të tjera	332,302	352,001
TVSH e zbritshme	240,252	442,550
Parapagime	36,329	59,958
Garanci	3,698	56,772
Akciza	-	5,652
Provizjon për aktive të tjera	(290,183)	(97,048)
<b>Totali</b>	<b>322,398</b>	<b>819,885</b>

Lëvizjet në provizionet e debitorëve të tjerë janë si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Më 31 dhjetor 2012</b> (Ndryshuar)
Gjendja në fillim të vitit	97,048	97,048
Provizjon për aktive të tjera	193,135	-
<b>Totali</b>	<b>290,183</b>	<b>97,048</b>

**12. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E SAJ**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Më 31 dhjetor 2012</b> (Ndryshuar)
Para në arkë	1,234	418
Llogari rrjedhëse në Lek	2,469	12,203
Llogari rrjedhëse në monedhë të huaj	1,954	5,581
<b>Totali</b>	<b>5,657</b>	<b>18,202</b>

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***13. KAPITALI I NËNSHKRUAR**

Më 31 dhjetor 2013 kapitali i nënshkruar i Shoqërisë është 5,126,461,000 Lek ndarë në 5,126,461 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 Lek secili (31 dhjetor 2012: 5,126,461,000 Lek ndarë në 5,126,461 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1,000 Lek secili).

Struktura e kapitalit aksionar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 është paraqitur si më poshtë:

	Numri i aksioneve	Pjesa në %
Anika Mercuria Refinery Associated Oil Sh.A.	4,357,491	85
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (më parë Ministria e Ekonomiksë, Tregtisë dhe Energjitikës)	768,970	15
<b>Totali</b>	<b>5,126,461</b>	<b>100</b>

Deri më 6 gusht 2013 80% të aksioneve të AMRA Oil ishin në pronësi të Anika Enterprises SA, ndërsa 20% zotërohej nga Refinery Associates of Texas.

Nga data 6 gusht 2013 të gjitha aksionet e zotëruara nga Anika Enterprises SA, u blenë nga Heaney Assets Corp.

**14. REZERVA LIGJORE**

Nuk ka ndryshime në rezervën ligjore që nga viti 2008. Rezerva ligjore u krijua në bazë të nenit 127 të ligjit nr. 9901, datë 14 maj 2008.

**15. REZERVA TË TJERA**

Nga fitimet e pashpërndara të viteve 2000 deri në 2006 u krijuan rezerva të tjera për qëllime buxhetimi.

**16. REZERVA NGA RIVLERËSIMI I PRONAVE**

Lëvizjet në rezervën nga rivlerësimi i pronave janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar)
Gjendja në fillim të vitit	69,012,901	72,417,845
Rënie që rrjedhin nga rivlerësimi i pronave	(24,189,795)	-
Transferime në tatimin e shtyrë nga fitimi i pashpërndarë	(3,202,339)	(3,404,944)
Rimarrje të detyrimit të tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	2,417,162	-
Detyrime mbi tatimin e shtyrë nga rritja e normës tatimore	(2,276,827)	-
<b>Gjendja në fund të vitit</b>	<b>41,761,102</b>	<b>69,012,901</b>

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***17. HUA MBARTËSE TË INTERESIT**

Huatë e marra nga bankat përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar)
<b>Hua bankare</b>	<b>12,136,346</b>	<b>5,311,040</b>
FBME Bank	7,010,000	-
Raiffeisen Bank	2,741,812	2,756,296
Credins Bank	1,885,000	2,044,928
Tirana Bank	361,776	370,325
Union Bank	50,716	52,207
Banka Kombëtare Tregëtare	87,042	87,284
<b>Overdrafte</b>	<b>150,323</b>	<b>160,790</b>
Credins Bank	150,323	160,790
Interesa të përllogaritura për huatë	188,746	-
Komisione disbursimi të shtyra	(12,187)	-
	<b>12,463,228</b>	<b>5,471,831</b>
<b>Hua nga palë të treta</b>	<b>11,964,372</b>	<b>10,513,362</b>
<b>Totali</b>	<b>24,427,600</b>	<b>15,985,192</b>
<b>Afatshkurtra</b>	<b>13,169,875</b>	<b>12,106,027</b>
<b>Afatgjata</b>	<b>11,257,725</b>	<b>3,879,165</b>

*Hua bankare*

Gjatë vitit 2013 Shoqëria u financua me borxh nga bankat e mëposhtme:

- Tre hua me afat nga FBME Bank për shumën totale prej 50,000 mijë Euro, me periudhë maturimi më të vogël se 3 vjet dhe normë interesi efektive të ponderuar 7% në vit;
- Hua me afat nga Raiffeisen Bank me normë interesi Libor USD 12m + 4% (min 6%) dhe periudhë maturimi prej 60 muajsh. Më 4 shkurt 2013 ARMO rishikoi kontratën e saj si bashkë-huamarrëse me Taci Oil ITSC dhe vendosi pronat e Rafinerisë së Fierit si kolateral për një overdraft në shumën 7,250 mijë USD disbursuar ndaj Taci Oil ITSC nga Raiffeisen Bank Sh.A. Gjatë vitit 2013 Taci Oil ITSC nuk arriti të shlyejë overdraftin e marrë dhe Raiffeisen Bank Sh.A. pretendon shlyerjen e overdraftit nga ARMO Sh.A. Në mënyrë që të lironte pasuritë e saj nga përmbarimi, Shoqëria mori përsipër shlyerjen e overdraftit. Për shlyerjen e këtij detyrimi Shoqëria shtoi detyrimet në shumën 768,958 mijë Lek dhe shpenzimi përkatës u njoh në zërin humbje të tjera siç paraqitet në Shënimin 29. Kontrata e overdraftit ndërmjet Raiffeisen Bank Sh.A. dhe Shoqërisë u nënshkrua më 31 mars 2014 me normë interesi USD 12m + 4% (min 6%) dhe periudhë maturimi 60 muaj.
- Hua me afat nga Credins Bank për shumën 1,885,000 mijë Lek, normë interesi 6% duke filluar nga data 1 dhjetor 2013 (2012: 8%) dhe periudhë maturimi 12 mujore;
- Hua me afat nga Tirana Bank me periudhë maturimi 9 mujore dhe normë interesi Bono Thesari 12M + 2%, min of 7.95%;
- Huatë nga Union Bank dhe BKT janë hua me afat dhe normë interesi të ponderuar 5.45% dhe periudhë maturimi më tepër se 5 vjet.

## **ARMO Sh.A.**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

#### **17. HUA MBARTËSE TË INTERESIT (VAZHDIM)**

Komisioni i disbursimit përcaktohet në përputhje me kushtet e çdo kontrate dhe amortizohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Norma e interesit për disbursimet varion nga 0.2% në 0.75% të kështit të disbursuar.

##### *Overdraftet*

Overdraftet nga Credins Bank me limit krediti prej 150,000 mijë Lek kanë normë interesi Tribor + 2.7% (min 6%).

##### *Hua nga palë të treta*

Huatë nga palë të treta përfaqësojnë hua me norma fikse të marra nga G&O Trading Sh.A. në shumën 921,150 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), Energy Trading Sh.A. në shumën 799,500 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), A&V Oil në shumën 505,415 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), Liona Sh.A. në shumën 299,500 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), Standart Oil Sh.A. në shumën 999,800 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), Eroil Sh.A. në shumën 2,947,226 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), Deveron Sh.A. në shumën 1,841,227 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), Tea Construction and Petrol Sh.A. në shumën 1,064,000 mijë Lek (2012: 0 mijë Lek), Fit-Mek-Oil Sh.A. në shumën 1,284,323 mijë Lek (2012: 522,247 mijë Lek), United Colors 1,196,185 mijë Lek (2012: 746,249 mijë Lek) dhe të tjera në shumën 141,815 mijë Lek (2012: 9,168,358 mijë Lek). Norma e interesit efektiv e ponderuar për huatë e mësipërme është 7% me bazë vjetore.

#### **18. PROVIGJONE**

Më 28 Mars 2012, Albpetrol paditi në Gjykatën e Rrethit Tiranë Shoqërinë duke kërkuar shlyerjen e detyrimeve në shumën 5,374,446 mijë Lek. Pas negociatave dhe rakordimit të balancave, palët ranë dakord për shumën 3,424,751 mijë Lek, e cila është e njohur në llogaritë e pagueshme në Shënimin 19. Kurse shuma e kontestuar në gjykatë është 1,680,715 mijë Lek. Albpetrol nuk njeh një faturë të lëshuar nga ARMO në shumën prej 992,923 Lek, për dhëniën më qira të çisternave për magazinimin e karburantit. Drejtimi beson se ka probabilitet të lartë që Shoqëria do të paguajë vetëm diferencën midis shumës së kontestuar dhe faturës së lëshuar; për këtë arsye vetëm shuma prej 674,042 mijë Lek është njohur si provigjon për çështjet ligjore në pasqyrat financiare. Shpenzimi përkatës është njohur në shpenzimet për provigjone në Shënimin 28.

ARMO Sh.A.

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**19. LLOGARI TË PAGUESHME DHE TË TJERA**

Llogaritë e pagueshme përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Llogari të pagueshme tregtare	9,906,454	8,620,135
Të pagueshme të tjera	391,100	407,838
<b>Totali</b>	<b>10,297,554</b>	<b>9,027,973</b>

Llogaritë e pagueshme përfaqësojnë shuma të pagueshme ndaj furnitorëve për aktivitetin e rafinerive, të tilla si Bankers Petroleum Albania Sh.A., Albpetrol Sh.A., K&E Sh.A. nga të cilat Shoqëria blen naftë bruto dhe lëndë të para.

Llogaritë të pagueshme të tjera përbëhen nga llogari të pagueshme ndaj furnitorëve për shpenzime administrative dhe shpenzime të tjera.

**20. DETYRIME TË TJERA DHE SHPENZIME TË LLOGARITURA**

Detyrime të tjera përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Penalite për taksën e akcizës	1,944,699	-
Detyrime për taksën e akcizës	619,548	77,950
Detyrimet ndaj Komunave	301,223	-
Të pagueshme ndaj personelit	299,091	293,750
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	233,112	220,002
Taksa e karbonit	190,398	153,570
Taksa kombëtare	113,478	164,274
Grante	63,574	63,574
Shpenzime të llogaritura	37,381	127,203
Detyrime të tjera	491,057	193,617
<b>Totali</b>	<b>4,293,561</b>	<b>1,293,940</b>

Gjatë vitit 2013 Shoqëria ka qenë subjekt i auditimeve të Autoriteteve Tatimore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për periudhën nga janari 2009 deri në maj 2013. Siç paraqitet në Shënimin 26, Shoqërisë i janë vendosur gjoba dhe detyrime shtesë nga autoritetet në lidhje me taksat doganore, akcizën dhe detyrime ndaj komunave.

Më 23 tetor 2013 Shoqëria ka nënshkruar një marrëveshje me Zyrën e Tatimpaguesve të Mëdhenj, duke përcaktuar detyrimin total për t'u paguar ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoriteteve Doganore, si dhe skedulën e shlyerjes së tyre.

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***21. TË ARDHURA**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Blue Diesel	1,850,448	2,210,067
Bitum	917,617	2,085,894
Naftë	457,368	916,770
Koks	91,798	207,957
Virgin Naphtha	-	310,816
Nënprodukte të tjera	23,480	102,195
<b>Totali</b>	<b>3,340,711</b>	<b>5,833,699</b>

Rafineritë e Ballshit dhe Fierit kanë punuar vetëm dy muaj në janar dhe në shkurt 2013, kështu që të ardhurat lidhen kryesisht me blerjen dhe shitjen e blue diesel-it sesa të produkteve të rafinuara.

**22. KOSTO E SHITJEVE**

Kosto e shitjeve përfaqëson shpenzime të drejtpërdrejta të blerjes së naftës bruto, lëndëve të tjera të para të tilla si lëndë djegëse dhe kosto të tjera direkte dhe indirekte që lidhen me aktivitetet e rafinimit.

**23. TË ARDHURA TË TJERA**

Të ardhura të tjera përbehen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Tarifa e rafinimit	136,436	-
Të ardhura të tjera	15,795	3,099
<b>Totali</b>	<b>152,231</b>	<b>3,099</b>

Të ardhurat nga rafinimi kryesisht kanë të bëjnë me shërbime rafinimi ofruar Trade Petrol and Drilling Sh.A në muajin e fundit të vitit në Rafinerinë e Fierit.

**24. AMORTIZIMI**

Shpenzimet e amortizimit përbehen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Amortizim i llogaritur mbi bazën tatimore të aktiveve afatgjata materiale	303,209	297,341
Teprica e amortizimit mbi rivlerësimin	3,558,155	3,782,993
<b>Totali</b>	<b>3,861,364</b>	<b>4,080,334</b>

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***24. AMORTIZIMI (VAZHDIM)**

Rafineritë e Ballshit dhe Fierit nuk kanë qenë operative për pjesën më të madhe të vitit. Për këtë arsye shuma e amortizimit të periudhës është njohur më vete në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe nën koston e shitjeve nuk është njohur asnjë shpenzim amortizimi.

**25. SHPENZIME PERSONELI**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Shpenzimet e pagave bruto	1,305,828	1,318,519
Shpenzimet e sigurimit të personelit	198,952	202,571
Shpenzime të tjera për personelin	1,452	-
<b>Totali</b>	<b>1,506,232</b>	<b>1,521,090</b>

**26. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Gjoha nga tatimet dhe autoritete të tjera	3,435,241	364,392
Shpenzime për taksat lokale	433,789	125,729
Shpenzime për energji elektrike	384,488	154,689
Shpenzime konsulence	120,988	139,933
Shpenzime sigurimi	118,563	11,899
Shpenzime për reklama	102,361	173,454
Komisione bankare	58,036	141,554
Riparime dhe mirëmbajtje	31,541	1,865,295
Shpenzime transporti	15,431	6,762
Shpenzime qiraje	7,824	4,009
Shpenzime monitorimi	-	111,136
Shpenzime të tjera	352,827	221,761
Humbje të tjera	237,145	2,242,033
<b>Totali</b>	<b>5,298,234</b>	<b>5,562,646</b>

Siç është shpjeguar në Shënimin 20, si rezultat i kontrolleve nga Autoritetet Tatimore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Shoqëria u ngarkua me gjoha dhe penalitete kryesisht në llogaritjen e akcizës, taksave kombëtare dhe taksës së karbonit.

Shpenzimet e energjisë elektrike lidhen me konsumin e energjisë elektrike në rafineritë dhe njësitë e tjera administrative.

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***27. HUMBJA NGA RËNIA NË VLERË TË AKTIVEVE FINANCIARE**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Humbje nga rënia në vlerë e huave ndaj shoqërive të tjera (Shënimi 7)	6,902,342	-
Humbje nga rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme (Shënimi 10)	2,583,579	-
Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve të tjera (Shënimi 11)	193,135	-
<b>Totali</b>	<b>9,679,056</b>	<b>-</b>

**28. SHPENZIME PROVIGJONI**

Shpenzimi i provigjonit përfshin provigjone për çështje të hapura gjyqësore me Albpetrol siç paraqitet dhe në Shënimin 18 "Provigjonet". Provigjoni për shumën 674,042 mijë Lek përfaqëson ndryshimin midis shumës së kontestuar dhe faturës së lëshuar.

**29. HUMBJE TË TJERA**

Humbje të tjera përfshijnë shpenzime për detyrime të ristrukturuara siç raportohet në Shënimin 18 "Hua mbartëse të interesit".

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012
Detyrime të tjera të ristrukturuara (Shënimi 17)	1,710,515	-
Detyrime të ristrukturuara - Raiffeisen Bank (Shënimi 17)	768,958	-
<b>Totali</b>	<b>2,479,473</b>	<b>-</b>

Humbje të tjera përfaqësojnë shpenzime të tjera imponuar ARMO-s për shkëlqe të marrëdhënieve tregtare të mëparshme me Fit Mek Oil dhe Tea Construction dhe Petrol Sh.A.

**30. TË ARDHURA / SHPENZIME FINANCIARE**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 (Ndryshuar)
Shpenzime interesi	1,226,027	1,542,122
Të ardhura nga interesi	(382)	-
<b>Totali</b>	<b>1,225,645</b>	<b>1,542,122</b>

Shpenzimet e interesit lidhen me interesat për huatë bankare dhe ndaj palëve të treta.



**ARMO Sh.A.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**31. TATIMI MBI FITIMIN**

**31.1. Tatimi mbi fitimin i njohur në fitim ose humbje**

Tatim fitimi përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar)
Tatimi mbi fitimin i vitit	-	-
Tatimi i shtyrë		
Tatimi i shtyrë i amortizimit të rivlerësuar të viti	355,816	378,049
<b>Totali</b>	<b>355,816</b>	<b>378,049</b>
	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar)
<b>Humbja e vitit</b>	<b>(24,440,738)</b>	<b>(12,444,128)</b>
<i>Shpenzime të pazbritshme:</i>		
Provigjone për rënien në vlerë të aktiveve dhe humbje të jashtëzakonshme	13,628,241	2,242,032
Amortizimi i vitit	3,558,780	4,080,336
Penalitetet	3,435,241	387,894
Shpenzime interesi	847,126	-
Shpenzime të tjera të pazbritshme	928,772	1,306,019
Shpenzime të tjera që nuk realizojnë të ardhura	92,785	-
	<b>22,490,945</b>	<b>8,016,281</b>
<b>Humbja e tatueshme</b>	<b>(1,949,793)</b>	<b>(4,427,847)</b>
Tatim fitimi me 15% (2012: 10%)	-	-

	Norma efektive tatimore	2013	Norma efektive tatimore	2012
Humbja para tatimit		<b>(24,440,738)</b>		<b>(12,444,128)</b>
Norma në fuqi e tatim fitimit	10%	2,444,074	10%	1,244,413
<i>Rregullime për:</i>				
Tatim fitimi mbi shpenzimet e pazbritshme	(9.2)%	(2,249,095)	(6.44)%	(801,628)
Tatim fitimi mbi humbjet e vitit për të cilat nuk është njohur tatim i shtyrë aktiv	(1.11)%	(271,446)	(1.66)%	(206,865)
<b>Totali i humbjes tatimore të mbartur</b>	<b>(0)%</b>	<b>-</b>	<b>2%</b>	<b>(235,920)</b>

ARMO Sh.A.

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

*(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)*

**31 TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

31.1 Tatimi mbi fitimin i njohur në fitim ose humbje (vazhdim)

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar)</b>
Humbjet tatimore nga viti 2010	-	2,068,649
Humbjet tatimore nga viti 2011	-	887,493
Humbjet tatimore nga viti 2012	-	4,427,848
	<u>-</u>	<u>7,383,990</u>

Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vite. Në bazë të ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi fitimin (i ndryshuar) Neni 27, Paragrafi 2, humbjet tatimore të vitit 2013 dhe ato të periudhave të mëparshme nuk mund të mbarten për shkak të ndryshimit të strukturës së pronësisë me më shumë se 50% (referoju Shënimit 1).

31.2. Tatimi mbi fitimin i njohur në të ardhura të tjera përmblendhëse

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar)</b>
Rivlerësimi i pronave	2,417,163	-
Rregullime të tatimit të shtyrë lidhur me ndryshimet e ligjeve dhe normave tatimore	(2,276,827)	-
	<u>140,336</u>	<u>-</u>

**32. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA**

Palët e lidhura me të cilat Shoqëria kryen transaksione janë aksionarët e saj dhe drejtimi kyç.

Transaksionet me palët e lidhura përfaqëson një transferim të burimeve, shërbimeve apo detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pavarësisht nëse është vënë një çmim. Një palë e lidhur konsiderohet një palë që ka kontroll mbi shoqërinë, kontrollohet nga shoqëria, apo është nën një kontroll të përbashkët të shoqërisë; është në një bashkpronësi me shoqërine; ka një kontroll të përbashkët mbi shoqërinë, apo është antare e manaxhimit kryesor apo është partnere e Shoqërisë.

Që nga 8 gushti 2013 struktura aksionare e Shoqërisë ndryshoi dhe transaksionet e përfshira në shënimin e palëve të lidhura janë vetëm për aksionarët e rinj pas datës së blerjes.

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***32. TRANSAKSIONE ME PALË TË LIDHURA (VAZHDIM)**

Çdo transaksion me palë e lidhura kryhet në kushte të lira tregu. Një përmbledhje me gjëndjet e palëve të lidhura paraqitet më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 (Ndryshuar)
<b>Pasqyra e pozicionit financiar</b>		
<i>Hua të dhëna palëve të treta – afatgjatë</i>		
AMRA Oil	314,528	323,580
<i>Hua të dhëna palëve të treta – afatshkurtër</i>		
Heaney Assets Corp.	943,650	-
<i>Llogari të arkëtueshme tregtare</i>		
Deveron Oil Albania Sh.A.	3,816	-
<i>Hua mbartëse të interesit</i>		
Deveron Oil Albania Sh.A.	1,841,227	-
<b>Pasqyra e fitimit ose humbjes</b>		
Kompensimi i drejtimit	189,010	-

**33. INSTRUMENTAT FINANCIARË****33.1. Rreziku i kreditimit**

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare për Shoqërinë nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga ky instrument. Vlera kontabël neto e aktivitetit financiar përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj kreditimit. Shoqëria mbikqyr rregullisht nivelet e rrezikut të riskut të kreditimit që ndërmerr.

Rreziku i kreditimit që lidhet me fondet likuide dhe instrumentat financiarë derivativë është i limituar duke qënë se palët e Shoqërisë janë bankat me vlerësime të larta kreditimi të caktuar nga agjensitë ndërkombëtare për vlerësimin e kreditit.

Ekspozimi maksimal neto ndaj rrezikut të kreditit në datën e raportimit është:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
Hua ndaj shoqërive të tjera, neto	314,528	6,930,617
Paradhënie palëve të treta	943,651	-
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, neto	1,294,786	4,539,446
Aktive të tjera, neto	322,398	819,855
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5,657	18,202
<b>Totali</b>	<b>2,881,020</b>	<b>12,308,120</b>

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***33. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****33.2. Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të ndeshet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrime financiare të cilat shlyhen nga transferimi i mjeteve monetare dhe aktiveve të tjera financiare.

Tabela e likuiditeteve më poshtë është hartuar në bazë të maturimeve kontraktuale të aktiveve financiare më 31 dhjetor 2013:

	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Më tepër se 1 vit	Vlera kontabël
<b>Aktive financiare</b>				
Hua ndaj shoqërive të tjera, neto	-	-	314,528	314,528
Paradhënie palëve të treta	943,651	-	-	943,651
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, neto	85,275	1,004,174	205,337	1,294,786
Aktive të tjera, neto	-	322,398	-	322,398
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	5,657	-	5,657
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>1,028,926</b>	<b>1,332,229</b>	<b>519,865</b>	<b>2,881,020</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Hua mbartëse të interesit	-	13,169,875	11,257,725	24,427,600
Provigjone	-	-	674,042	674,042
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	4,003,294	2,247,964	4,046,296	10,297,554
Detyrime të tjera	400,000	2,826,438	1,067,123	4,293,561
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>4,403,294</b>	<b>18,244,277</b>	<b>17,045,186</b>	<b>39,692,857</b>
<b>Hendeku i likuiditetit</b>	<b>(3,374,368)</b>	<b>(16,912,048)</b>	<b>(16,525,321)</b>	<b>(36,811,837)</b>
<b>Hendeku kumulativ</b>	<b>(3,374,368)</b>	<b>(20,286,416)</b>	<b>(36,811,737)</b>	

Tabela e likuiditeteve më poshtë është hartuar në bazë të maturimeve kontraktuale të aktiveve financiare më 31 dhjetor 2012:

	Më pak se 6 muaj	6-12 muaj	Më tepër se 1 vit	Vlera kontabël
<b>Aktive financiare</b>				
Hua ndaj shoqërive të tjera, neto	-	-	6,930,617	6,930,617
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, neto	280,714	555,847	3,702,885	4,539,446
Aktive të tjera, neto	-	-	819,885	819,885
Paraja dhe ekuivalentët e saj	-	18,202	-	18,202
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>280,714</b>	<b>574,049</b>	<b>11,453,387</b>	<b>12,308,150</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Hua mbartëse të interesit	-	12,106,027	3,879,165	15,985,192
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	3,267,963	1,835,055	3,924,955	9,027,973
Detyrime të tjera	475,333	504,977	313,630	1,293,940
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>3,743,296</b>	<b>14,446,059</b>	<b>8,117,750</b>	<b>26,307,105</b>
<b>Hendeku i likuiditetit</b>	<b>(3,462,582)</b>	<b>(13,872,010)</b>	<b>3,335,637</b>	<b>(13,998,955)</b>
<b>Hendeku kumulativ</b>	<b>(3,462,582)</b>	<b>(17,334,592)</b>	<b>(13,998,955)</b>	

**33. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****33.3. Rreziku i tregut**

Analiza e ndjeshmërisë është përgatitur mbi bazën që shuma e borxhit neto, raporti i normave të interesit gjysëmvariabël mbi borxhin dhe përqindja e instrumentave financiare në monedhë të huaj janë të gjitha konstante. Analizat e ndjeshmërisë janë të destinuara për të ilustruar ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve në variablat e tregut për instrumentat financiare të Shoqërisë dhe tregojnë ndikimin në fitim ose humbje dhe kapitalin aksionar, kur është i zbatueshëm.

Analizat përjashtojnë ndikimin e lëvizjeve të variablave të tregut në vlerën kontabël neto të provigjoneve.

Supozimet e mëposhtme janë bërë për të llogaritur analizat e ndjeshmërisë:

- Ndjeshmëria e pasqyrës së pozicionit financiar lidhet me llogaritë e arkëtueshme tregtare, aktivet financiare, huamartjet nga bankat dhe shoqëritë e tjera, llogari të pagueshme etj, të shprehura në monedhë të huaj.
- Ndjeshmëria e fitimit përkatës përpara tatimit është efekti i ndryshimeve të supozuara në rreziqet përkatëse të tregut. Kjo bazohet në aktivet financiare dhe detyrimet financiare të mbajtura më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012.

Ndikimi mbi kapitalin është i njëjtë me ndikim në fitimin para tatimit.

*Ndjeshmëria e normave të interesit*

Huatë e dhëna palëve të treta, llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe detyrime të tjera janë aktive financiare dhe detyrime që nuk mbartin interes.

Gjithashtu gjatë vitit Shoqëria nuk ka patur depozita me afat që mbartin interes.

**33.3. Rreziku i tregut (vazhdim)**

Më poshtë paraqiten tre hua të cilat mbartin norma interesi të luhatshme dhe një analizë ndjeshmërie ndaj ndryshimeve të mundshme në normat e interesit të tregut:

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
<b>Detyrime financiare</b>		
<i>Me normë interesi variabël:</i>		
Hua mbartëse të interesit	3,396,189	3,030,491
<b>Totali</b>	<b>3,396,189</b>	<b>3,030,491</b>

*Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit*

	Pasqyra e fitimit ose humbjes	
	100 bp Rritje	100 bp Rënie
Instrumenta me norma variabël më 31 dhjetor 2013	339,619	(339,619)
Instrumenta me norma variabël më 31 dhjetor 2012	303,049	(303,049)

*Rreziku i këmbimit valutor*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit valutor kryesisht nga huatë e marra në USD, EUR. Shoqëria nuk ka nënshkruar ndonjë transaksion këmbimi të ardhshëm ose transaksione të produkteve derivative fikse deri më 31 dhjetor 2013.

**ARMO Sh.A.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)***33. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)****33.3. Rreziku i tregut (vazhdim)***Rreziku i këmbimit valutor (vazhdim)*

Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë sipas monedhave më 31 dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<b>Euro</b>	<b>USD</b>	<b>LEK</b>	<b>Vlera kontabël</b>
Hua ndaj shoqërive të tjera, neto	-	68,246	246,282	<b>314,528</b>
Paradhënie palëve të treta	943,651	-	-	<b>943,651</b>
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, neto	-	492,432	802,354	<b>1,294,786</b>
Aktive të tjera, neto	-	-	322,398	<b>322,398</b>
Paraja dhe ekuivalentët e saj	1,532	1,022	3,103	<b>5,657</b>
<b>Totali i aktiveve monetare</b>	<b>945,183</b>	<b>561,700</b>	<b>1,374,137</b>	<b>2,881,020</b>
Hua mbartëse të interesit	7,779,003	3,300,217	12,615,190	<b>24,427,600</b>
Provigjone	-	674,042	-	<b>674,042</b>
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	176,181	3,380,793	6,704,811	<b>10,297,554</b>
Detyrime të tjera	-	-	4,293,561	<b>4,293,561</b>
<b>Totali i detyrimeve monetare</b>	<b>7,955,184</b>	<b>8,124,011</b>	<b>23,613,562</b>	<b>39,692,757</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>(7,010,001)</b>	<b>(7,562,311)</b>	<b>(22,239,425)</b>	

Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të Shoqërisë sipas monedhave më 31 dhjetor 2012 paraqitet si më poshtë:

	<b>Euro</b>	<b>USD</b>	<b>LEK</b>	<b>Vlera kontabël</b>
Hua ndaj shoqërive të tjera, neto	5,196,865	375,931	1,357,821	<b>6,930,617</b>
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, neto	-	524,516	4,014,930	<b>4,539,446</b>
Aktive të tjera, neto	-	-	819,885	<b>819,885</b>
Paraja dhe ekuivalentët e saj	1,693	1,646	14,863	<b>18,202</b>
<b>Totali i aktiveve monetare</b>	<b>5,198,558</b>	<b>902,093</b>	<b>6,207,499</b>	<b>12,308,150</b>
Hua mbartëse të interesit	551,471	7,902,473	7,531,248	<b>15,985,192</b>
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	146,196	4,748,807	4,132,970	<b>9,027,973</b>
Detyrime të tjera	-	-	1,293,940	<b>1,293,940</b>
<b>Totali i detyrimeve monetare</b>	<b>697,667</b>	<b>12,651,280</b>	<b>12,958,158</b>	<b>26,307,105</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>4,500,891</b>	<b>(11,749,187)</b>	<b>(6,750,659)</b>	

## ARMO Sh.A.

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë të shprehura në mijë Lek, përveç kur shprehet ndryshe)

## 33. INSTRUMENTAT FINANCIARË (VAZHDIM)

### 33.3. Rreziku i tregut (vazhdim)

*Analiza e ndjeshmërisë së kurseve të këmbimit*

Tabela më poshtë tregon ndjeshmërinë ndaj një ndryshimi të mundshëm të arsyeshëm në kursin e këmbimit valutor, me të gjitha variabla të tjerë të mbajtura konstante:

	2013	2012
EUR zhvlerësohet me 10%	774,319	(450,089)
EUR vlerësohet me 10%	(774,319)	450,089
USD zhvlerësohet me 10%	682,912	1,174,919
USD vlerësohet me 10%	(682,912)	(1,174,919)

## 34. ANGAZHIME DHE PASIGURITË

*Çështjet ligjore*

*Proçesi ligjor më Albpetrol*

Siç është shpjeguar në Shënimin 18, që nga data 28 mars 2014 Shoqëria ka një çështje gjyqësore të hapur me Albpetrol Sh.A. në lidhje me një shumë të pretenduar për vlerën 1,680,715 mijë lekë. Albpetrol Sh.A. nuk njeh një faturë të lëshuar nga Shoqëria për shumën 992,923 lekë për çisternat e magazinimit të karburanit të dhëna me qira. Drejtimi beson se ekziston një mundësi e madhe që Shoqëria do të paguajë vetëm diferencën mes vlerës së pretenduar dhe vlerës së faturës; për rrjedhojë vetëm vlera 674,041 lekë është njohur në pasqyrat financiare.

*Proçesi i arbitrazhit me SGS*

Në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Zvicër ka një çështje ligjore në proces, ku palët e përfshira janë Anika Enterprises S.A., ARMO Sh.A, Societe Generale de Surveillance S.A (SGS) dhe Wallis Trading Inc. për shumën 26,146,075 USD, lidhur me zhdukjen e një sasive inventari të përdorur si kolateral në një financim të siguruar nga Wallis Trading Inc. Përveç kësaj, Shoqëria ka marrë kërkesa të tjera nga Wallis Trading Inc lidhur me marrëveshje të tjera lehtësuese të firmosura mes palëve Wallis Trading Inc dhe ARMO Sh.A, Taci Oil ITSC, Anika Enterprises S.A. dhe KUID Sh.A, në shumën 15,018,925 USD dhe balanca të tjera të lidhura me këto marrëveshje. Shoqëria po shqyrton vlefshmërinë e këtyre kërkesave. Rezultati përfundimtar nga çështjet e mësipërme aktualisht nuk mund të përcaktohet nga Shoqëria, dhe për këtë arsye nuk ka është njohur provigjion lidhur me detyrimet e mundshme. Bazuar në informacionin e dhënë, rezultati përfundimtar i çështjeve të mësipërme momentalisht nuk mund të përcaktohet dhe ARMO Sh.A. nuk ka regjistruar asnjë provigjion lidhur me detyrimet e mundshme në performancën dhe pozicionin e saj financiar më 31 dhjetor 2013.

Përveç rasteve të mësipërme, Shoqëria aktualisht është e përfshirë në disa çështje ligjore në lidhje me aktivitetet e saj në vitet e kaluara. Drejtimi është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale nga këto çështje ligjore në proces më 31 dhjetor 2013.

## 35. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje pas datës së raportimit, që do të kërkonte rregullime apo paraqitje shtesë në këto pasqyra financiare.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and high-quality service to clients, delivering the insights they need to address their most complex business challenges. Deloitte's approximately 200,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.

###

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private e limituar nga garancitë, secila prej tyre është entitet ligjor i ndarë dhe i pavarur. Ju lutem shikoni [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about) për një përshkrim më të detajuar të strukturës ligjore të Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare.

Deloitte ofron shërbime në auditim, takse, konsulencë dhe shërbime të konsulencës financiare klientëve private dhe publikë në të gjitha industritë që ata operojnë. Me një rrjet global firmash anëtare, në më shumë se 150 shtete, Deloitte sjell ekspertizë me nivel ndërkombëtar dhe shërbime me cilësi të lartë për klientët e saj, duke i dhënë bizneseve njohuritë që i nevojiten për të adresuar sfidat më komplekse që ato hasin. Pothuajse 200,000 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.

Str. "Elbasani"  
Pallati poshtë Fakultetit  
Gjeologji - Miniera  
Tirana, Albania

[www.deloitte.al](http://www.deloitte.al)

© 2014 Deloitte Albania